



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 19 qershor 2023  
Nr. ref.: RK 2215/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI146/21**

Parashtrues

**Bukurije Maksutaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.  
nr. 483/2020, të 18 marsit 2021**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përberë nga:

Gresa Caka-Nirnani, kryetare  
Bajrarn Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radornir Laban, gjyqtar  
Rernzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhrni Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Bukurije Maksutaj nga Suhareka (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqësojnë Admir Salihu dhe Arbnora Shefkju, avokatë nga Ferizaj.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 483/2020] e 18 marsit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [Rev. nr. 483/2020] e 20 majit 2021 të së njëjtës gjykatë, si dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 333/16] e 11 shkurtit 2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Parashtruesja e kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar [Rev. nr. 483/2020] të Gjykatës Supreme të Kosovës të 18 marsit 2021 më 20 prill 2021.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 10 gusht 2021, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të cilën Gjykata e pranoi më 16 gusht 2021.
7. Më 19 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin [GJR. KI146/21] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 13 shtator 2021, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj që të dorëzojë në Gjykatë kopjen e fletëkthesës si dëshmi se kur parashtruesja e kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 20 shtator 2021, Gjykata Themelore në Ferizaj dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar, e cila qartë tregon se Aktgjykimi Rev. nr. 483/2021 i Gjykatës Supreme i 18 marsit 2021 i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 20 prill 2021, ndërsa Vendimin Rev. nr. 483/2020 për korrigjimin e Aktgjykimit Rev. nr. 483/2021, të 18 marsit 2021, parashtruesja e kërkesës e pranoi më 31 maj 2021.
10. Më 8 dhjetor 2022, Gjykata e shqyrtoi këtë rast në seancën shqyrtuese, i cili u kthye për plotësim dhe kompletim.

11. Më 9 dhjetor 2022, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj që të dorëzojë në Gjykatë dosjen e plotë në këtë rast.
12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 20 dhjetor 2022, Gjykata Themelore në Ferizaj iu përgjigj Gjykatës se shkresat e kësaj lënde janë në Gjykatën e Apelit për shkak të kërkesës së parashtrueses për përsëritje të procedurës në këtë lëndë të 25 majit 2021.
14. Më 22 dhjetor 2022, Gjykata i kërkoi Gjykatës së Apelit informata në lidhje me fazën e vendimmarrjes në të cilën është kjo lëndë, si dhe komente lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën e Apelit.
15. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit iu përgjigj Gjykatës se sipas kërkesës për përsëritje të procedurës të parashtrueses së kërkesës, kjo kërkesë mori një numër të ri (CN. nr. 112/2021) dhe se është emëruar gjyqtari raportues i cili është njoftuar për kërkesën e Gjykatës.
16. Më 8 shkurt 2022, Gjykata e shqyrtoi këtë rast në seancën shqyrtuese, i cili u kthye për plotësim dhe kompletim.
17. Më 24 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.
18. Në përputhje me rregullin 62 (Mendimet konkurruese) të Rregullores së punës të Gjykatës, gjyqtari Radomir Laban ka përgatitur mendim konkurrues, i cili do të publikohet së bashku me këtë Aktgjykim.

### **Përmbledhja e fakteve**

19. Gjykata thekson që në fillim se parashtruesja e kërkesës inicioi një kontest pune me shkollën fillore ku ajo punon dhe se kontesti kaloi në të gjitha fazat e procedurës, administrative dhe gjyqësore, duke përfunduar në Gjykatën Supreme. Më poshtë, Gjykata do të përmend secilën procedurë veç e veç.

#### ***Procedura administrative***

20. Nga viti 2011 deri në vitin 2012, parashtruesja e kërkesës ka qenë e angazhuar me kontratë njëvjeçare, si arsimtaree gjuhës shqipe në Shkollën Fillore "Lasgush Poradeci" në fshatin Muzeqinë, paralelja e ndarë në fshatin Vojnovc (në tekstin e mëtejme: shkolla fillore), e cila i përket Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes.
21. Më 19 korrik 2012, sipas shkresave të lëndës, shkolla fillore përsëri shpalli konkurs për mësimdhënës të gjuhës shqipe për vitin shkollor 2012 dhe 2013. Parashtruesja e kërkesës aplikoi por nuk u pranua për shkak të mosplotësimit të kushteve të përgjithshme të konkursit. Duke qenë se vendi i punës nuk ishte plotësuar dhe viti shkollor kishte filluar, shkolla fillore e angazhoi parashtruesen e kërkesës si arsimtare të gjuhës shqipe pa konkurs publik me kontratë njëvjeçare (nr. 29-2/6-05/18) nga 12 nëntori 2012 deri më 31 gusht

2013. Pas kësaj date, shkolla fillore, përmes akt emërimit (nr. 29-2/6-05/18) të 1 prillit 2013, ia vazhdoi parashtrueses së kërkesës marrëdhënien e punës për një periudhë të pacaktuar.

22. Për shkak të numrit të reduktuar të nxënësve, shkolla fillore anuloi mësimet në paralelen e ndarë në fshatin Vojnovc, në të cilën paralele ishte angazhuar parashtruesja e kërkesës. Duke marrë parasysh situatën e krijuar rishtazi dhe nevojat reale, shkolla shpalli një konkurs të ri publik (nr. 05/264) më 4 gusht 2015, për pozitën e mësimdhënësit të gjuhës shqipe, për mësimin: "Kulturë shkrimi", në Muzeqinë.
23. Parashtruesja e kërkesës nuk ka aplikuar në këtë konkurs, por më 14 gusht 2015 ka kërkuar anulimin e konkursit (05/111/1363) të 4 gushtit 2015 nga shkolla fillore, përkatësisht nga Drejtoriae Arsimit e Komunës së Shtimes.
24. Më 24 gusht 2015, shkolla fillore, përkatësisht Drejtoria e Arsimit në Komunën e Shtimes, e njoftoi parashtruesen e kërkesës se konkursi nuk mund të anulohet dhe se ajo nuk ka kualifikim adekuat profesional për orët e "Kulturës së shkrimit", ndërsa ajo nuk u pranua në konkursin për orët e gjuhës shqipe dhe se vendi i saj i punës paraqet tepriçë teknologjike si pasojë e uljes së normës së orëve.
25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Komisionin për Ankesa të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes, duke pretenduar se shkarkimi i saj ishte i paligjshëm si rezultat i diskriminimit të hapur ndaj saj dhe se ndërprerja e marrëdhënies së punës ishte bërë pa paralajmërim dhe në një kohë kur parashtruesja e kërkesës ishte shtatzënë.
26. Më 7 shtator 2015, Komisioni për Ankesa i Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes (përmes Aktvendimit 05/016/23171) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e vërtetoi plotësisht Njoftimin e 24 gushtit 2015. Të njëjtën ditë, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë kundër Aktvendimit (05/016/23171) në Komisionin për Ankesa të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes tek Inspektori i Sektorit për Arsim të Komunës së Ferizajt.
27. Më 18 shtator 2015, Inspektorati i Sektorit për Arsim i Komunës së Ferizajt i është përgjigjur (Ref. 10/1-7, nr. prot. 2/767) ankesës së parashtrueses, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar në aktet e aplikueshme juridike. Në arsyetimin e njoftimit të Inspektorit thuhet se parashtruesja e kërkesës "*ka krijuar marrëdhënie pune me DKA në Shtime, si punëdhënës, pa procedurë të konkursit dhe kontrata e punës nuk mund të konsiderohet e ligjshmedhepërpasoj, nuk mund të pretendoj në vazhdimin e kontratës sëpunës pa procedura të konkursit publik*".

#### **Procedura gjyqësore përkitazi me kontestin e punës**

28. Më 1 tetor 2015, parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi kundër Aktvendimit (05/016/23171) të 7 shtatorit 2015 të Komisionit për Ankesa të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes në Gjykatën Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), duke kërkuar që të anulohen si të paligjshëm Aktvendimi (05/016/23171) i 7 shtatorit 2015 i Komisionit për Ankesa të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes dhe Konkursi (05/111/17363) i 4 gushtit 2015 i shkollës fillore.

29. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata Themelore (përmes Aktgjykimit C. nr. 577/15) miratoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, (I) duke anuluar si të paligjshëm Vendimin nr. 05/016/23171, të 7 shtatorit 2015, Konkursin e 4 gushtit 2015, me numër të referencës 05/111/17363, si dhe Njoftimin nr. 05/309, të 24 gushtit 2015, të lëshuar nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Shtimes dhe (II) obligoi Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Shtimes që parashtruesene kërkesës ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, arsimtare lëndore, në shkollën filllore, me orar të plotë, i cili korrespondon me kushtet profesionale të paditëses, si dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale sipas kontratës së punës dhe aktit të emërimit.
30. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore përkitazi me vendimet e kontestuara të Drejtorisë për Arsim të Komunës së Shtimes, arsyetoi se këto vendime, *“është i kundërligjshëm dhe nuk ka bazë ligjore dhe nëkundërshtim të plotë me rregullativën ligjore pasi që duke u bazuar nëUdhëzimin administrativ Nr. 06/15, e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku citohet se të gjithëpunëtorëve të arsimit që janë në mardhënje pune me gradën Baqellor e që janë të licencuar do tu vazhdohet kontrata e punës edhe 3 vite, me qëllim që gjatë kësaj periudhe puntorët qëpunojnë në arsim tëarrjnë kualifikimin e duhur, andaj nëkëtë rast duke u bazuar nëUdhëzimin e cekur më lartë e paditura ka pasur obligim qëpaditëses nëkëtë rast ti vazhdoj kontratënperkatësisht të mos ja ndërpres mardhënjen e punës. Se vendimi mbi refuzimin e ankesës sëpaditëses, është i kundërligjshëm gjykata këtë fakt e bazon në nenin53 të Ligjit tëpunës me numër 03/L-212 ku shume kjarhtë thuhet se **shkëputja e kontratës sëpunës nuk mund të ndodh gjatë kohës kur punëtorja është shtatzën [...]**,andaj edhe gjykata vlereson se konform nenit 53 të Ligjit të punës e paditura në këtë rast ka bërë shkelje të këtij neni pasi që paditësja siq u cekë edhe më lartë në kohën e ndërprerjes së mardhënjes së punës ka qenështatzëne. [...] gjykata vlerëson se ndërprerja e mardhënjes së punës paditëses është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të cilat i kemi përmendur më lartë pasi që vendimi mbi ndërprerjen e mardhënjes së punës, përkatësisht vendimi mbi refuzimin e ankesës sëpaditëses nëkëtë rast dhe konkursi i shpallur publik me datë 04.08.2015 janë nëkundërshtim në radhë të parë me udhëzimin Administrativ nr. 06/15, lëshuar nga MASHT-i si dhe dispozitat ligjore të parapara në Ligjin e punës të cilat po ashtu i kemi përmendur më lartë, po ashtu gjykata vlerëson se edhe njoftimi me nr.05/309 i dt. 24.08.2015, i lëshuar nga [...] Drejtor i Arsimit në Shtime, se paditësjaështë shpallur si tepricë teknologjike, është në kundërshtim te plote me Ligjin e punës neni 53, te Ligjit tëpunës, nr. 03/L-212”.*
31. Më 31 dhjetor 2015, Komuna e Shtimes parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit (C. nr. 577/15) të Gjykatës Themelore, duke konsideruar se i njëjti është përfshirë me (i) shkelje esenciale të dispozitave procedurale; (ii) vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe se parashtruesja e kërkesës është pranuar në marrëdhënie të punës jashtë procedurës standarde, përkatësisht konkursit.
32. Më 11 shkurt 2020, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac. nr. 333/16, aprovoi si të bazuar ankesën e Komunës së Shtimes, duke ndryshuar Aktgjykimin (C. nr. 577/15) e Gjykatës Themelore, në atë mënyrë që e kishte refuzuar padinë e parashtruar kundër Aktvendimit (05/016/23171) të Komisionit për Ankesa të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes dhe Konkursit (05/111/17363) të shkollës filllore të 4 gushtit 2015.
33. Gjykata e Apelit arsyetoi se,

*“paditësja me pretendimet për paligjshmërinë e aktvendimit të datës 07.09.2015, si dhe për anulimin e konkursit të datës 04.08.2015, nuk mund të gjejnë mbështetje ligjore. Kërkesa e paditëses për anulimin e aktvendimit të datës 07.09.2015 dhe rrjedhimisht edhe konkursin e 04.08.2018, nën maskën e qëllimit që ajo kishte ose ishte pajisur për të mbuluar këto orë mësimore, nuk ishin të bazuara, sepse paditësja, duke mos shprehur aspak interesin për të marrë pjesë në konkursin e të paditurit, për këtë pozitë, nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore në një proces ku ajo nuk është pjesëmarrëse, si dhe për faktin se paditësja kërkon anulimin e konkursit publik të shpallur nga e paditura, për pozitën që paditësja pretendon se i përket asaj?! Fakti se paditësja i ka mbajtur këto orë mësimore deri në kohën e rishpërndarjes së tyre, nuk legjitimon kurrfarë të drejtë të paditëses për monopolizimin e vendit tëpunës dhe paragjykimin e rezultatit të një konkursi publik sidomos duke ditur faktin se paditësja nuk kishte krijuar marrëdhënien e punëspërorët e lëndës kulturore shkrimi, veç se ajo mbulonte këtë pjesë të orëve me marrëveshje me të paditurën, për periudha të kufizuara kohore. Më tej gjykata e shkallës së dytë vlerëson se shpallja e konkursit nga e paditura nuk mund të konsiderohet si veprim i paligjshëm apo diskriminues i të paditurës nga se politikat e punësimittë kuadrit mësimor i administron dhe menaxhon e paditura. Gjykata e Apelit vlerëson se kërkesa për anulim të konkurseve qësnojnë realizimin e politikave të punëdhënësve nuk mund të përfitojnë me pretendime për të drejta të siguruara apo privilegjuara nga kandidatë potencialtë aktualë. Konkurrenca, në këtë rast, nënkupton ballafaqim të vlerave njerëzore e profesionale karshi kërkesave dhe kriterëve që kërkohet në punëdhëni, ndaj paditësja nuk mund të pretendojë realizimin e një të drejte për të cilën ajo nuk e kishte të garantuar me asnjë akt apo normë ligjore, veç se e njëjta do të mund të nënshtrohej, si gjithë të tjerët, rregullave të konkursit publik për pozitën kontestuese dhe se janë të pabazuara pretendimet se asaj e paditura i ka cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e diskriminimit dhe paligjshmërie tjera të pretenduara, prandaj, dhe për këtë arsye, pozita juridike e gjykatës së shkallës së parë është dashur të ndryshohet në drejtim të zgjidhjes së drejtë dhe meritore të çështjes kontestuese, siç është vendosur në vendimin e këtij aktgjykimi.. Gjykata e Apelit, në rastin e iniciuar nga paditësja, nuk vlerëson ligjshmërinë, e marrëdhënies së mëparshme tëpunës së saj me të paditurën, mirëpo vlerëson se në rastin konkret paditësja nuk ka bazë për kthim në vendin e mëparshëm të punës, për shkak të ekzistimit të marrëdhënies, së mëparme tëpunës tek e paditura pasi që procesi i regrutimit që ka udhëhequr paditësja, për pozitën kontestuese, ka qenë proces i drejtë dhe i ligjshëm dhe se paditësja nuk ka marrë pjesë fare në këtë proces ndaj dhe pretendimeve të saja nuk mund të u ipet mbrojtje juridike, dhe si rrjedhim i kësaj gjendjeje çfarëdo pretendimi për diskriminim të paditëses nuk është i bazuar në kuptim të nenit 5 të Ligjit të Punës, ngase duke vlerësuar në tërësi procesin e regrutimit që ka udhëhequr e paditura, kolegji nuk ka gjetur se ka pasur diskriminim për shkak se paditësja, nuk i është nënshtruar (nuk ka qenë pjesëmarrëse), procesit të konkurrimit që ka hapur e paditura”.*

34. Në një datë të pacaktuar, kundër Aktgjykimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit, parashtruesja e kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
35. Më 18 mars 2021, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 483/2020, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses së kërkesës.
36. Gjykata Supreme arsyetoi se,

*“Nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit të paditëses se gjykata e shkallës së dytë fare nuk ka shqyrtuar dispozitat ligjore nga neni 53 dhe 71 të Ligjit të Punës, se paditësja nuk është njoftuar me kohë për largim nga puna konform neni 71 dhe e dyta kur ajo është larguar nga puna ka qenë shtatzënë që sipas neni 53 të ligjit të punës ndalohet shpallja e kontratës në kohën e shtatzënisë, nga arsyeja se gjykata e revizionit vlerëson se paditësja në konkursin e shpallur nga e paditura më 19.7.2012 nuk pranohet, por përkundërsaj paditësja ka mbajtur orët e mësimit në lëndën kulturore e shkrimi, deri në përfundim të vitit shkollor 2014.2015, në shkollën fillore Muzeqinë, për këtë periudhë paditësja nuk ka lidhur kontratë të punës, çka nënkupton se ka qenë në marrëdhënie faktike të punës, prandaj e paditura nuk ka njoftuar paditësen për largimin e saj nga puna ashtu si kërkon dispozita e neni 71 të Ligjit të punës.*

*Me vetë faktin se paditësja nuk është paraqitur në konkursin e datës 4.8.2015, ajo nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore, në të cilën nuk është pjesëmarrëse, prandaj edhe shpallja e konkursit nga e paditura nuk mund të konsiderohet si veprim i paligjshëm apo diskriminues i të paditurës, prandaj me të drejtë edhe gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vlerësuar se politikat e punësimit të kuadrit mësues i administron dhe menaxhon e paditura.*

*Pretendimet e revizionit se gjykata e shkallës së dytë ka bërë tejkalim të kërkesës për shkak të kërkesës së paditëses nuk ka qenë atakimi i konkursit për shkak të parregullsive ligjore, por kërkesa e saj ka qenë anulimi i vendimit nr. 05/016/23171 i datës 07.09.2015 që është shpallur si tepriçë teknologjike dhe si pasojë anulimin e konkursit për shkak që në kohën kur është shpallur ky konkurs paditësja ka qenë në vend të punës me afat të caktuar AKT EMËRIM (arsimtar lëndor me 20 orë gjuhë shqipe) dhe ky konkurs ka cenuar marrëdhënien e saj të punës, sepse DKA Shtime ishte arsyetuar se është reduktuar fondi i orëve, e në të njëjtën kohë kishte shpallur konkurs për pranimin në punë të mësimdhënësve të rinj me kualifikim të njëjtë. Ku sipas Kontratës Kolektive DKA nuk mund të shpallë konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës derisa të mos sistemohen punëtorët e shpallur tepriçë teknologjike, nuk qëndrojnë nga arsyeja se e paditura nuk do të shpallte konkursin për vende të punës, në rast se paditësja do të ishte në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, fakti se paditësja ka mbajtur orët mësimore deri në kohën e rishpërndarjes së orëve, nuk e legjitimon paditësen të kërkojë anulimin e konkursit dhe kthimin në punë, nga fakti se paditësja nuk kishte krijuar marrëdhënie të punës për lëndën kulturore shkrimi, por këto orë i mbulonte me marrëveshje me të paditurën, edhe pse nuk ishte pranuar në konkursin e shpallur nga e paditura në vitin 2012”.*

### **Procedura sipas kërkesës për përsëritje të procedurës**

37. Në një datë të pacaktuar, parashtuesja e kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme propozim për përsëritje të procedurës, duke deklaruar se me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit (Ac. nr. 333/2016) të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit (Rev. nr. 483/2020) të Gjykatës Supreme në të dyja procedurat në përbërje të kolegjit të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar A. Z.
38. Më 20 maj 2021, Gjykata Supreme me Vendimin Rev. nr. 483/2021, ka bërë korrigjimin e gabimit teknik në Aktgjykimin Rev. nr. 483/2020 të Gjykatës Supreme të 18 marsit 2021, në atë mënyrë që në vend të gjyqtarit A.Z, i cili gabimisht është futur si anëtar i trupit gjyqësor, është shënuar gjyqtari B.I, që është konstatuar në bazë të procesverbalit të shqyrtimit.

39. Më 25 maj 2021, parashtruesja e kërkesës parashtrori të njëjtin propozim për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Themelore, me pretendime dhe kërkesa të njëjta si në Gjykatën Supreme.
40. Më 30 shtator 2021, Gjykata Themelore ia përcolli Gjykatës së Apelit propozimin për përsëritjen e procedurës së parashtrueses së kërkesës për vendim të mëtutjeshëm.
41. Më 21 tetor 2021, Gjykata e Apelit pranoi propozimin për përsëritjen e procedurës së parashtrueses së kërkesës dhe e regjistroi me numër CN. nr. 112/2021, kjo çështje është ende në fazën e vendimmarrjes në Gjykatën e Apelit.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

42. Parashtruesja e kërkesës thekson se aktgjykimet e kontestuar të gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
43. Lidhur me nenet e lartpërmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës ka disa pretendime në lidhje me këtë shkelje të pretenduar.

(i) *Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me shkeljen e parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme*

Lidhur me këtë shkelje, parashtruesja e kërkesës pretendon, “aktgjykimi Rev. 483/20 i cili i është dorëzuar Parashtrueses së Kërkesës me datën 20.04.2021, rezulton se për çështje të njëjtë ka vendosur një kolegji i cili nuk është në përputhje me ligjin. Sepse në përbërje të kolegjit ka qenë gjyqtari i njëjtë A. Z., i cili kishte qenë edhe në përbërje të kolegjit të Apelit për të njëjtën lëndë, shkelje e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastin nr. KI138/19, parashtrues Avdi Mujaj).

*E dyta se kjo çështje nuk është shqyrtuar nga gjykata dëshmon fakti se pas më shumë se 41 ditëve pas dorëzimit të Aktgjykimit nga gjykata e revizionit e njëjta me datë 31.05.2021 Parashtrueses së Kërkesës i dorëzon një aktvendim përmirësues lidhur me aktgjykimin rev. 483/20 me arsyetim të një gabimi teknik dhe në vend të gjyqtarit A. Z., i paraqitur si anëtar i trupit gjykues duhet të jetë gjyqtari B. I.” dhe*

*Pikërisht ky fakt dëshmon se përbërja e trupit gjykues ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 67 pika d të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe mosrespektimi i kësaj ndalese paraqet shkelje flagrante të para. 1 dhe 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, e cila sipas paragrafit 2 të nenit 22 të Kushtetutës zbatohet drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.*

*Nuk mund të pranohet arsyetimi se vendosja e gjyqtarit A. Z. në vend të gjyqtarit B. I. ishte gabim teknik. Kjo sepse ekziston një procedurë e veçantë për përjashtimin e gjyqtarit dhe shtrohet pyetja se kur është përjashtuar gjyqtari A. Z. dhe kur është caktuar gjyqtari B. I., për faktin se ky i fundit, nga data 16.10.2020 deri në momentin e shqyrtimit të kësaj çështje nga gjykata e revizionit, avokati, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, av. A. S. dhe anëtari i prezantuar i trupit gjykues B. I. janë anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, fakt që shërben për përjashtimin e këtij gjyqtari nga vendimmarrja për shkak të konfliktit të interesit. Në momentin kur Gjykata Supreme nxori aktvendimin korrigjues, ajo duhet t'i kishte dhënë parashtrueses së kërkesës mundësinë e ankesës në lidhje me këtë fakt për përbërjen e trupit gjykues, prandaj, në thelb, në çdo variant bëhet fjalë për shkelje të lartpërmendura që cenojnë rëndë parimin e gjykimin të drejtë”.*



44. Pretendimin e saj lidhur me përbërjen e kolegjit, përkatësisht me faktin se gjyqtari B.I. ka qenë në përbërje të kolegjit, parashtruesja e kërkesës e mbështet me Vendimin nr. 07-V-077 të 16 tetorit 2020 të Kuvendit të Kosovës, me të cilin, në mesin e të tjerëve, avokati i parashtrueses së kërkesës dhe gjyqtari B.I. janë emëruar si anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, gjë që parashtruesja e kërkesës e konsideron si arsye të mjaftueshme për përjashtimin e këtij gjyqtari nga çështja konkrete.

(ii) *Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit*

45. Në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, si dhe me mosarsyetimin e vendimeve të kontestuara, parashtruesja e kërkesës thekson, "Parashtruesja e Kërkesëspërmes revizionit kishte kërkuar që Gjykata Supreme të konstatoj se Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë fare nuk ka shqyrtuar dispozitat ligjore nga neni 53 dhe 71 të Ligjit tëpunës qëjanë dy fakte që bazohen në prova dhe në ligj, e para paditësja nuk është njoftuar me kohëpër largim nga puna konform nenit 71 dhe e dyta kur ajo është larguar nga puna ka qenështatzënë që sipas nenit 53 të ligjit tëpunës ndalohet shkëputja e kontratës në kohën e shtatzanisë.

*Nga Gjykata Supreme është kërkuar që të vlerësoj:*

- *A është shkëputur marrëdhënia e punës në bazë të ligjit tëpunës nenit 71 me vendimin 05/016/23171 i datës 07.09.2015, kërkesa kryesore e padisë.*
- *A është e lejuar shkëputja e marrëdhënies së punës gjatë kohës së shtatzanisë në kuptim të nenit 53 të ligjit të punës.*
- *Konkursi aka qenëpër vendin e punës nëcilën ka punuar paditësja ku paraprakisht ishte shpallur tepricë teknologjike, apo se ka kontratë të paligjshme.*
- *A është shpallur ky konkurs përnjë vend pune, për të cilin dikush tjetër ishte nëmarrëdhënie pune në kohën e shpalljes së tij sipas një kontrate akt emrimi të ligjshëm.*

*Këto çështje të ngritura përmes revizionit, Gjykata Supreme fare nuk i ështëpërgjigjur me çka është cenuar parimi i vendimit të arsyetuar."*

(iii) *Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës*

46. Parashtruesja e kërkesës përkitazi me kohëzgjatjen e procedurës pretendon se, "me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe më pas me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Gjykata e Apelit nëse e llogarisim datën e ankesës të ushtruar nga Komuna e Shtimes e datës **31.12.2015** dhe vendimin e Gjykatës së Apelit të datës **10.02.2020** rezulton që gjykatës së Apelit i është dashur mbi 5 vite ta shqyrtoj një rast nga marrëdhënia e punës raste këto që kanë prioritet për shkak të natyrës së punës. E kur në rastin konkret kemi të bëjmë me një punëtor të arsimit një arsimtare, rezulton qe parashtrueses së kërkesës i është mohuar e drejta për je cikël mësimor nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, apo respektivisht 5 gjenerata kanë kaluar dhe një mësimdhënëses nuk i është shqyrtuar lënda."

47. Parashtruesja e kërkesës, në fund, kërkon nga Gjykata që ta deklarojë të pranueshme kërkesën e saj dhe të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe që më pas ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 483/2020 të 18 marsit 2021, dhe ta kthejë rastin në Gjykatën Supreme për rigjykim dhe rivendosje.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

### **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTATE NJERIUT**

#### **Neni 6**

#### **(E drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
- të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;;
  - t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
  - të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
  - të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
  - të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

[...]

## **LIGJI I PUNËS**

### **Nr. 03/L-212**

[...]

#### **Neni 53**

#### **Ndalimi i shkëputjes së kontratës**

*Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji.*

[...]

#### **Neni 70**

#### **Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit**

- Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:*
  - ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;*
  - i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;*
  - punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;*
  - punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:*
    - 1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe*
    - 1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës;*
  - punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;*
  - punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:*

1.6.1. i punësuari është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuari ka marrë përshtetimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuari duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

3. Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t'ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuari ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet.

4. Marrëveshjet Kolektive ose Aktet e Brendshme të Punëdhënësit mund t'i specifikojnë llojet e keq sjelljeve ose të shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuari t'i nënshtrohet ndërprerjes të kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve të përsëritura.

#### **Neni 71**

#### **Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës**

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

#### **Neni 72**

#### **Procedura para ndërprerjes së Kontratës**

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.

2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.

3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

[...]

#### **LIGJI nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE**

[...]

## **PËRJASHTIMI I GJYQTARIT NGA GJYKIMI**

### **Neni 67**

*67.1 Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:*

- a) në qoftë se është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkë kreditor apo bashkë debitor ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;*
- b) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;*
- c) në qoftë se është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;*
- d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjese në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose te organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;*
- e) në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;*
- f) në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;*
- g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.*

[...]

### **Korrigjimi i aktgjykimit**

#### **Neni 165**

*165.1 Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë.*

*165.2 Korrigjimi i gabimeve bëhet me aktvendim të posaçëm që shkruhet në fund të origjinalit të aktgjykimit, kurse palëve u dërgohet kopja e aktvendimit të tillë.*

*165.3 Po që se midis origjinalit dhe kopjes së aktgjykimit ekziston mospajtimi në pikëpamje të ndonjë vendimi të përmbajtur në dispozitivin e aktgjykimit, palëve do t'u dërgohet kopja e korrigjuar e aktgjykimit, duke treguar se me këtë kopje të aktgjykimit zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në rast të këtillë afati për ankim kundër pjesës së korrigjuar të aktgjykimit fillon të ecë nga dita e dorëzimit të kopjes së korrigjuar të aktgjykimit.*

*165.4 Për korrigjimin e aktgjykimit gjykata vendosë pa dëgjimin e palëve.*

[...]

## **PËRSËRITJA E PROCEDURËS**

### **Neni 232**

*231.1 Procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës:*

a) në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore;

b) në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, po që se ndjekja e çështjes në gjyq apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar me vonë nga pala;

c) në qoftë se vendimi përfundimtar i gjykatës është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarëve apo të ekspertëve ose në dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar përmbajtja e pasaktë;

d) në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është pasojë e veprës penale të gjyqtarit, të përfaqësuesit ligjor apo me prokurë të palës, kundërshtare apo të personit të tretë;

e) në qoftë se pala fiton mundësinë ta përdorë vendimin e formës së prerë të gjykatës, i cili më parë, është dhënë në procedurën e zhvilluar midis palëve të njëjta për të njëjtën kërkesëpadi;

f) në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është bazuar në një vendim tjetër gjyqësor, ose në vendimin e ndonjë organi tjetër, kurse ky vendim është ndryshuar, prishur apo anuluar në mënyrë të prerë;

g) në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme.

### Neni 233

233.1 Nga shkaqet e treguara në nenin 232 pika a) dhe b) të këtij ligji nuk mund të kërkohet përsëritja e procedurës, po që se ato janë përdorur pa sukses në procedurën e mëhershme. 233.2 Nga shkaqet e treguara në nenin

232 pika g) e këtij ligji përsëritja e procedurës mund të kërkohet vetëm po që se pala, pa fajin e saj, nuk ka mundur ti parashtrij këto rrethana para se të ketë marrë fund procedura e mëparshme me vendim gjyqësor të formës së prerë.

### Neni 234

234.1 Propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, dhe atë:

a) në rastin nga neni 232, pika a) e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë;

b) në rastin nga neni 232, pika b) e këtij ligji në qoftë se në procedurë si paditës apo si i paditur ka vepruar personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar personit të tillë;

c) në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor të saj, e po që se përfaqësuesi ligjor, gjegjësisht me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, nga dita kur pala ka marrë dijëni për këtë shkak;

d) në rastin nga neni 232, pika c) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijëni për aktgjykimin penal të formës së prerë;

e) në rastin nga neni 232, pika d) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijëni për vendimin penal të formës së prerë, e nëse procedura penale nuk mund të zhvillohet, atëherë nga dita kur ka marrë dijëni për pezullimin e procedurës penale, apo për rrethanat për shkak të të cilave nuk mund të iniciohet procedura penale;

f) në rastet nga neni 232, pika e) dhe f) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur ta përdorë vendimin e formës së prerë që është shkak për përsëritjes së procedurës;

g) në rastin nga neni 232, pika g) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur t'i parashtrijë në gjykatë faktet e reja, gjegjësisht mjetet provuese të reja.

234.2 Po që se afati i caktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të fillonte të rrjedhë para së vendimi të ketë marrë formë të prerë, ky afat do të llogaritet nga momenti në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në qoftë se kundër tij nuk është paraqitur ankesa, gjegjësisht nga dita e dorëzimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës së lartë të dhënë në shkallë të fundit.

234.3 Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet, përveçse kur përsëritja kërkohet nga shkaqet e përmendura në nenin 232, pika a dhe b të këtij ligji.

#### Neni 235

Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendosë gjykata e shkallës së dytë, dhe atë gjyqtari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë në procedurën e mëparshme.

#### Neni 236

236.1 Propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet gjithmonë gjykatës që e ka dhënë vendimin e shkallës së parë.

236.2 Në propozim duhet treguar sidomos: baza ligjore në mbështetje të të cilës kërkohet përsëritja e procedurës, rrethanat nga të cilat rezulton se propozimi është paraqitur në afatin ligjor dhe mjetet provuese me të cilat arsyetohen thëniet e propozuesit.

*Neni 237*

*237.1 Propozimin për përsëritjen e procedurës të paraqitur pas afatit ligjor, atë jo të plotë, apo të palejueshëm, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit pa mbajtur seancë gjyqësore.*

*237.2 Po që se gjykata e shkallës së parë nuk e hedhë poshtë propozimin, një ekzemplar të tij ia dërgon palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor të përgjigjet lidhur me të.*

*Neni 238*

*Pasi të arrijë përgjigja lidhur me propozimin, apo pasi të skadojë afati për përgjigje, gjykata propozimin, bashkë me përgjigjen në të, po që se është paraqitur, me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë brenda afatit prej tetë (8) ditësh.*

*Neni 239*

*239.1 Gjukata e shkallës së dytë vendosë mbi propozimin për përsëritjen e procedurës zakonisht jashtë seance për shqyrtim kryesor.*

*239.2 Po që se gjykata vjen në përfundim se është i domosdoshëm shqyrtimi i tillë, ajo do të veprojë në pajtim me dispozitat e neneve 191 dhe 193 të këtij ligji.*

[...]

**Pranueshmëria e kërkesës**

48. Gjukata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.

49. Në këtë drejtim, Gjukata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjukata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjukatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

50. Gjukata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjukata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:



Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individidi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ”.*

51. Sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 483/2020] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 18 marsit 2021. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ajo pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
52. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 (Kriteri i pranueshmërisë) të Rregullores së Punës. Rregulli 39 (2) dhe 39 (3) (b) i Rregullores së Punës përcakton:

*“2. Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

[...]

*(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:*

[...]

*(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;*

[...]

53. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

54. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”.
55. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtresit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
56. Gjykata rikujton se thelbi i rastit të parashtreses së kërkesës bazohet në faktin se ajo në dy raste është angazhuar nga shkolla fillore sipas kontratës për kohë të caktuar (nga viti 2011 deri në vitin 2012 dhe nga 12 nëntori 2012 deri më 31 gusht 2013) dhe se më pas, angazhimi i saj për të njëjtin pozitë është vazhduar me aktemërimin (nga 1 prilli 2013 e tutje) i cili ka qenë për një kohë të pacaktuar, ku pastaj punëdhënësi i saj, shkolla fillore, e njoftoi se për vendin e saj të punës nuk kishte më nevojë reale sepse paralelja ku ajo jepte mësim po shuhet dhe nuk ka nevojë që ajo të angazhohet më tej në punët në të cilat ka qenë e angazhuar sipas akt emërimit. Në të njëjtën kohë, shkolla fillore shpalli konkursin për vendin e ri të punës në të cilin parashtresja nuk aplikoi. Parashtresja e kërkesës inicioi procedurën administrative pranë organeve kompetente administrative duke kontestuar njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës dhe shpalljen e konkursit të shkollës fillore. Kjo procedurë përfundoi me Aktvendimin e organit kompetent të Komunës së Shtimes, përmes të cilit është refuzuar ankesa e parashtreses së kërkesës.
57. Pikërisht në lidhje me këtë, parashtresja e kërkesës inicioi pranë Gjykatës Themelore procedurën kontestimore me qëllim të kundërshtimit të Aktvendimit të Komunës së Shtimes për ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës dhe për anulimin e konkursit, duke konsideruar se vetë fakti që ajo kishte qenë në marrëdhënie pune tek i njëjti punëdhënësi është arsye e mjaftueshme që ajo të angazhohet sërish dhe se nuk është e nevojshme të shpallet konkursi për këtë. Megjithatë, përkundër faktit se Gjykata Themelore në procedurën kontestimore anuloi Aktvendimin e Komunës së Shtimes, kjo procedurë kontestimore përfundoi me aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, me të cilat kërkesëpadia e parashtreses së kërkesës është refuzuar si e pabazuar. Më pas, parashtresja e kërkesës parashtroi kërkesë për korrigjim të aktgjykimit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit (Ac. nr. 333/2016) të Gjykatës së Apelit dhe aktgjykimit (Rev. nr. 483/2020) të Gjykatës Supreme në të dyja procedurat në përbërjen e kolegjit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar, Gjykata Supreme më pas ka korrigjuar gabimin teknik në aktgjykimin Rev. nr. 483/2020 e Gjykatës Supreme të 18 marsit 2021. Pas kësaj, parashtresja e kërkesës ka parashtuar të njëjtin propozim për përsëritjen e procedurës në Gjykatën

Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, me pretendime dhe kërkesë identike si në Gjykatën Supreme. Gjykata Themelore ia përcolli Gjykatës së Apelit propozimin për përsëritjen e procedurës së parashtrueses së kërkesës për vendim të mëtejshëm. Gjykata e Apelit e ka regjistruar propozimin për përsëritjen e procedurës së parashtrueses së kërkesës me numrin e ri CN. nr. 112/2021.

58. Duke shqyrtuar thelbin e pretendimeve ankimore në kërkesë, Gjykata gjen se parashtruesja pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ku si pretendime figurojnë tri aspekte të shkeljes, përkatësisht, (i) shkelja e parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme sepse në bazë të pretendimeve të saj përbërja e kolegjit nuk ishte në përputhje me ligjin; (ii) shkelja në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit; dhe (iii) shkelja për shkak të kohëzgjatjes së procedurës pranë Gjykatës së Apelit.
59. Në bazë të specifikave të rastit konkret, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilat, sipas nenit 53 [Interpretimi i dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
60. Gjykata në vijim do t'i trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së, në tri aspekte, përkitazi me: (i) shkeljen e parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme për shkak se, në bazë të pretendimeve të saj, përbërja e kolegjit nuk ishte në përputhje me ligjin; (i) shkeljen në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit; dhe (ii) shkeljen për shkak të kohëzgjatjes së procedurës pranë Gjykatës së Apelit.

**(i) Vlerësimi kushtetutës i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës në lidhje me shkeljen e parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarëve A.Z. dhe B.I. në procesin e vendimmarrjes**

61. Përkitazi me procedurat e zhvilluara në lidhje me pretendimet për pjesëmarrjen e gjyqtarëve A.Z. dhe B.I. në procesin e vendimmarrjes, Gjykata rikujton se lidhur me këtë çështje, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur fillimisht në Gjykatën Supreme kërkesën për përsëritje të procedurës. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Supreme nxori Vendimin [Rev. nr. 483/2021] e 20 majit 2021, me të cilin është korrigjuar gabimi teknik në përbërjen dhe emrat e anëtarëve të kolegjit.
62. Më pas, lidhur me këtë çështje, parashtruesja e kërkesës, krahas kërkesës në Gjykatë, paraqiti edhe kërkesën për përsëritje të procedurës pranë Gjykatës Themelore, e cila në bazë të nenit 238 të LPK-së ia përcolli Gjykatës së Apelit ku çështja është ende në fazën e vendimmarrjes me numrin e ri të rastit CN. nr.112/2021. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se vendimi i fundit sipas mjetit të fundit juridik të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës, me aktgjykimin Rev. nr. 483/2020 të Gjykatës Supreme të 18 marsit 2021, me të cilin refuzoi kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës, e cila është parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata gjithashtu vëren se në bazë të kërkesës për korrigjim të aktgjykimit Rev. nr. 483/2020 të Gjykatës Supreme të 18 marsit 2021, Gjykata Supreme me vendimin për korrigjim [Rev. nr. 483/2020] të 20 majit 2021 korrigjoi gabimin teknik në aktgjykimin e saj. Më pas, parashtruesja e kërkesës parashtroi të njëjtën kërkesë në Gjykatën Themelore dhe të Apelit, duke e cilësuar si kërkesë për përsëritjen e procedurës.:

63. Lidhur me këtë, Gjykata në radhë të parë thekson se kjo kërkesë e parashtrueses së kërkesës për përsëritjen e procedurës, gjendet në Gjykatën e Apelit është në fazën e vendimmarrjes. Gjykata e Apelit e regjistroi këtë kërkesë të parashtrueses me numrin e ri CN nr. 112/2021.
64. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja e kërkesës konteston edhe përbërjen e kolegjit të Gjykatës Supreme në përbërjen e ndryshuar pas korrigjimit teknik të bërë me vendimin [Rev. nr. 483/2021] të 20 majit 2021, me gjyqtarin B.I në përbërje të kolegjit. Megjithatë, parashtruesja e kërkesës nuk e inicioi këtë pretendim në asnjë nga parashtrësit e tij pranë gjykatave të rregullta.
65. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një rast krejtësisht të ri që nuk është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata konsideron se këto pretendime të parashtrueses së kërkesës hyjnë në kategorinë (ii) e pretendimeve me “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes” dhe si të tilla të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës..

**(ii) Vlerësimi kushtetues i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit**

66. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtrueses së kërkesës në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit, konsiston në pretendimin se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë shkelur Kushtetutën, duke arsyetuar se ajo: *“nuk është njoftuar me kohë për largim nga puna konform nenit 71 dhe e dyta kur ajo është larguar nga puna ka qenë shtatzëne që sipas nenit 53 të Ligjit të punës ndalohet shkëputja e kontratës në kohën e shtatzënisë”*.
67. Lidhur me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar dallimin në mes të *“kushtetutshmërisë”* dhe *“ligjshmërisë”* dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për atë sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues i kërkesës: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues i kërkesës: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues i kërkesës: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
68. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka pohuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo vetë nuk mund të vlerësojë faktet që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e *“shkallës së katërt”*, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).

69. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me interpretimin e gabuar të ligjeve të aplikueshme nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.
70. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme arsyetuan në detaje përse nuk e pranuan kërkesën e parashtrueses.
71. Së pari, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [Ac. nr. 333/16], ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë në mënyrë të tillë që refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses me arsyetimin se, “[...] Kërkesa e paditëses për anulimin e aktvendimit të datës 07.09.2015 dhe rrjedhimisht edhe konkursin e 04.08.2018, nën maskën e qëllimit që ajo kishte ose ishte pajisur për të mbuluar këto orë mësimore, nuk ishin të bazuara, sepse paditësja, duke mos shprehur aspak interesin për të marrë pjesë në konkursin e të paditurit, për këtë pozitë, nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore në një proces ku ajo nuk është pjesëmarrëse, si dhe për faktin se paditësja kërkon anulimin e konkursit publik të shpallur nga e paditura, për pozitën që paditësja pretendon se i përket asaj?! Fakti se paditësja i ka mbajtur këto orë mësimore deri në kohën e rishpërndarjes së tyre, nuk legjitimon kurrfarë të drejtë të paditëses për monopolizimin e vendit të punës dhe paragjykimin e rezultatit të një konkursi publik sidomos duke ditur faktin se paditësja nuk kishte krijuar marrëdhënien e punës për orët e lëndës kulturë shkrimi, veç se ajo mbulonte këtë pjesë të orëve me marrëveshje me të paditurën, për periudha të kufizuara kohore”.
72. Më tej, Gjykata Supreme me Aktgjykimin [Rev. nr. 483/2020], vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se, “[...] Nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit të paditëses se gjykata e shkallës së dytë fare nuk ka shqyrtuar dispozitat ligjore nga neni 53 dhe 71 të Ligjit të Punës, se paditësja nuk është njoftuar me kohë për largim nga puna konform nenit 71 dhe e dyta kur ajo është larguar nga puna ka qenë shtatzëne që sipas nenit 53 të ligjit të punës ndalohet shkëputja e kontratës në kohën e shtatzënisë, nga arsyeja se gjykata e revizionit vlerëson se paditësja në konkursin e shpallur nga e paditura më 19.7.2012 nuk pranohet, por përkundër kësaj paditësja ka mbajtur orët e mësimin në lëndën kulturore e shkrimit, deri në përfundim të vitit shkollor 2014-2015, në shkollën fillore Muzeqinë, për këtë periudhë paditësja nuk ka lidhur kontratë të punës, çka nënkupton se ka qenë në marrëdhënie faktike të punës, prandaj e paditura nuk ka njoftuar paditësen për largimin e saj nga puna ashtu si kërkon dispozita e nenit 71 të Ligjit të punës.  
Me vetë faktin se paditësja nuk është paraqitur në konkursin e datës 4.8.2015, ajo nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore, në të cilën nuk është pjesëmarrëse, prandaj edhe shpallja e konkursit nga e paditura nuk mund të konsiderohet si veprim i paligjshëm apo diskriminues i të paditurës, prandaj me të drejtë edhe gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vlerësuar se politikën e punësimit të kuadrit mësimor i administron dhe menaxhon e paditura. [...]”.
73. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson që përtej pretendimeve për interpretimin e gabuar të Ligjit të Punës, parashtruesja e kërkesës nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim dhe zbatim i ligjit nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” ose “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesen e kërkesës, apo se si procedurat pranë Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i kanë marrë parasysht të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit,

pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe se të njëjtat i kanë arsyetuar, si dhe kanë arsyetuar në mënyrë të qartë përse kërkesa e parashtrueses nuk është e pranueshme (shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës, KI64/20, parashtruesi kërkesës: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

74. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të Kushtetutës për shkak të interpretimit dhezbatimit të gabuar të ligjit në fuqi dhe mosarsyetimit të vendimeve të kontestuara janë(i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

***(iii) Vlerësimi kushtetues i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës lidhur me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm***

75. Gjatë trajtimit të këtij pretendimi, Gjykata rikujton edhe një herë këtë pretendim të parashtrueses së kërkesës, e cila, ndër të tjera, thekson se kohëzgjatja e procedurës në Gjykatën e Apelit bazohet në faktin se ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë Komuna e Shtimes e paraqiti në Gjykatën e Apelit më 31 dhjetor 2015, ndërsa kjo e fundit nxori aktgjykimin më 10 shkurt 2020, që në vetvete përbën një periudhë të gjatë kohore, përkundër faktit se parashtruesja në lidhje me procedurën në Gjykatën e Apelit kishte paraqitur 9 (nëntë) urgjenca, duke theksuar vazhdimisht urgjencën e procedurës për shkak se bëhet fjalë për një kontest pune. Sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata e Apelit duhet të kishte vendosur brenda një periudhe të shkurtër kohore pikërisht për faktin se nuk kemi të bëjmë me një rast tepër të ndërlikuar dhe bëhet fjalë për një çështje nga kontesti i punës.
76. Në këtë rast, për të përcaktuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës në lidhje me shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese që kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata do të merret me: (i) vërtetimin e periudhës së kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore; (ii) parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, dhe (iii) arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave para gjykatave të rregullta.

***(i) Periudha që do të merret parasysht***

77. Duke iu referuar praktikës së saj dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata ka vlerësuar se përlllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastin e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë* [nr. 9616/81](#) të 23 prillit 1987, paragrafi 64; shih gjithashtu rastin *Poiss kundër Austrisë*, GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 50, dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. [KI127/15](#), parashtrues *Mile Vasović*, Aktvendim për papranueshmëri i 15 qershorit 2015, paragrafi 43; [KI81/16](#), parashtrues *Valdet Nikqi*, Aktgjykim i 31 majit 2017; [KI19/17](#), Aktvendim për papranueshmëri i 21 shkurtit 2018, paragrafi 50). Një proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, [nr. 8130/78](#) Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74; si dhe rastin e Gjykatës [KI177/19](#), parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 98). Prandaj, kërkesa për gjykim brenda një kohe të arsyeshme zbatohet për të gjitha fazat e procesit gjyqësor që

synon zgjidhjen e kontestit, duke mos përjashtuar fazat pas gjykimit mbi meritat (shih rastin e GJEDNJ-së, *Robins kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [nr. 118/1996/936](#), Aktgjykim i 23 shtatorit 1997, paragrafët 28-29).

78. Gjykata vëren se në rastin konkret kemi të bëjmë me një procedurë në të cilën parashtruesja e kërkesës kontestoi Aktvendimin (05/016/23171) e Komisionit për Ankesa të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Shtimes, të 7 shtatorit 2015, përkatësisht anulimin e Konkursit (05/111/1363) të 4 gushtit 2015. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës, siç u shpjegua më parë, paraqiti padinë e saj më 1 tetor 2015. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të 9 dhjetorit 2015 e aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës. Më pas, më 31 dhjetor 2015, pala kundërshtarë paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila, përmes Aktgjykimit të 11 shkurtit 2020, aprovoi ankesën dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë. Gjatë periudhës kohore nga viti 2015 deri në vitin 2020, parashtruesja e kërkesës, lidhur me këtë lëndë, paraqiti në Gjykatën e Apelit 9 (nëntë) urgjenca, duke theksuar vazhdimisht urgjencën e procedurës për shkak se bëhet fjalë për një kontest pune.
79. Prandaj, Gjykata konstaton se periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, sipas paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, në rastin konkret, llogaritet nga data e paraqitjes së ankesës në Gjykatën e Apelit, përkatësisht ngadata 31 dhjetor 2015 deri në vendimin përfundimtar në lidhje me padinë, përkatësisht Aktgjykimin [Ac. nr. 333/16] e Gjykatës së Apelit të 11 shkurtit 2020, që paraqet një periudhë kohore prej 4 vite, 1 muaj e 11 ditë (katër vite një muaj e njëmbëdhjetë ditë).

(ii) *Parimet relevante*

80. Gjykata para së gjithash thekson se, sipas praktikës konsistente të GJEDNJ-së, e cila është reflektuar edhe në praktikën e Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e palëve në procedurë; (c) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon parashtruesi në kontest (shih rastet e GJEDNJ-së, *Mesić kundër Kroacisë*, [nr. 19362/18](#), Aktgjykim i 5 majit 2022, paragrafi 127; *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. [43391/18 17766/19](#), Aktgjykim i 12 tetorit 2021, paragrafi 63; *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. [18381/05](#), Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010, paragrafi 44; *Gjonboçari dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, [nr. 10508/02](#), Aktgjykim i 23 tetorit 2007, paragrafi 61; *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. [53176/99](#), [nr. 35382/97](#), Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 38; *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 6 prillit 2000; *Frydlender kundër Francës*, [nr. 30979/96](#), Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43; *Sürmeli kundër Gjermanisë*, [nr. 75529/01](#), Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, [nr. 76943/11](#), Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 143; *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. [41720/13](#), Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 209; shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: [KI07/15](#), parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2016, paragrafët 53-62; [KI23/16](#), parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017, paragrafi 58; [KI18/18](#), parashtrues *Isuf Musliu*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 qershorit 2018, paragrafi 43; [KI13/19](#), parashtrues *Fevzi Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 qershorit 2019, paragrafët 65-72; [KI177/19](#), parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 16 prillit 2019, paragrafët 96-106; [KI104/20](#), parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2021, paragrafi 46; [KI135/20](#), parashtruese *Hava Behxheti*, cituar më lart, paragrafët 39-54).

(iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

81. Gjykata vëren se rasti i parashtrueses së kërkesës ka rrjedhë si pasojë e një kontesti të punës në mes të parashtrueses së kërkesës dhe Komunës së Shtimes. Parashtruesja e kërkesës përmes padisë ka kërkuar anulimin e Njoftimit për ndërprerjen e angazhimit të saj në punë dhe Aktvendimit për konkursin si dhe që ajo të kthehet në vendin e mëparshëm të saj të punës .
82. Ashtu siç është elaboruar edhe më sipër, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të marrë parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlíkueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e parashtrueses së kërkesës; (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesen e kërkesës në kontest.

(a) Ndërlíkueshmëria e rastit

83. Përkítazi me ndërlíkueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës përmes të cilave ishte theksuar se ndërlíkueshmëria e rastit mund të ndërlíkdhjet me çështje faktike dhe ligjore, por gjithashtu mund të ndërlíkdhjet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150; *Nicolae Virgiliu Tânase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, nr. 12539/86, Aktgjykim i 19 shtatorit 1994, paragrafi 55; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63 dhe *Cipolleta kundër Italisë*, nr. 38259/09, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 44, ku edhe përkundër ndërlíkueshmërisë së procedurave të falimentimit, GJEDNJ-ja kishte konstatuar se të njëjtat ishin zvarritur në kundërshtim me kriterin e gjykimit të drejtë “brenda një afati të arsyeshëm” siç garantohet me nenin 6 (1) të KEDNJ-së; po ashtu, shih rastet e Gjykatës, [KI18/18](#), parashtrues *Isuf Musliu*, cituar më lart, paragrafi 45; dhe [KI104/20](#), parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 48).
84. Në këtë rast, Gjykata vëren se rasti i parashtrueses së kërkesës, krahas shqyrtimit gjyqësor, është shqyrtuar edhe në procedurën administrative pranë organeve të administratës, përkatësisht Komunës së Shtimes dhe Inspektoratit të Punës, dhe në lidhje me kërkesëpadinë e saj janë përfshirë edhe palë të tjera. Si rezultat i këtij konkluzioni në kontekstin e procedurës gjyqësore, Gjykata vëren se palë në këtë procedurë, përveç parashtrueses së kërkesës, janë edhe organet e tjera të administratës publike që kanë interes të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e kësaj çështjeje..
85. Përveç kësaj, kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës i referohet pretendimit të saj për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e saj e punës dhe kontrata për themelimin e së njëjtës. Në këto rrethana, duke u bazuar në faktin se kërkesëpadia e saj ka të bëjë me përcaktimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, Gjykata vlerëson se një pretendim i tillë konsiderohet në parim duke dëgjuar palën ndërgjyqëse në seancë, dhe duke shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse që lidhen me këtë. pretendim. Prandaj, në këto rrethana, Gjykata vlerëson se rasti i parashtrueses së kërkesës, i cili është aktualisht në shqyrtim është mjaft i ndërlíkuar..

(b) Sjellja e parashtruesit të kërkesës



86. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave në parim kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat procedural të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, parashtruesit e kërkesave duhet të kenë parasysh, gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve të kërkesave përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së, *McFarlane kundër Irlandës*, nr. [31333/06](#), Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafi 148; *Eckle kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 82; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI07/15](#), parashtrues *Shefki Zogiani*, cituar më lart, paragrafi 55).
87. Në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, disa raste të sjelljes së parashtruesve të kërkesës të cilat mund të kontribuojnë në zvarritjen e procedurës:
- Mungesa e gatishmërisë/vullnetit së palëve për të paraqitur parashtrësia mund të kontribuojë në ngadalësimin e procedurës (shih, rastin: *Vernillo kundër Francës*, nr. 11889/85 aktgjykimi i 20 shkurtit 1991, paragrafi 34);
  - Ndryshimi i shpeshtë i përfaqësuesit ligjor (shih, rastin: *König kundër Gjermanisë*, nr. 6232/73, aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 103);
  - Kërkesa ose lëshimet që ndikojnë në zhvillimin e procedurës (shih, rastin: *Acquaviva kundër Francës*, nr. 19248/91, aktgjykim i 21 nëntorit 1995, paragrafi 61), ose mungesa e vëmendjes në ndjekjen e hapave procedural (shih, rastin: *Keaney v. i Irlandës*, nr. 72060/17, arsyetim i 30 prillit 2020, paragrafi 95);
  - Inicimi i gabuar i procedurës pranë një gjykate jokompetente (shih, rastin: *Beaumartin kundër Francës*, nr. 15287/89, aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, paragrafi 33);
  - Sjellje e dëmshme e dëshmuar me parashtrësia të shumta dhe pretendime të tjera (shih, rastin: *Pereira da Silva kundër Portugalisë*, nr. 77050/11, aktgjykim i 22 marsit 2016, paragrafët 76-79).
88. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës, vëren se parashtruesja e kërkesës ka qenë më se aktive me kërkesa të njëpasnjëshme për përshpejtim dhe informata lidhur me gjendjen e rastit të saj në Gjykatën e Apelit që i ka paraqitur në periudhën nga 31 dhjetori 2015, deri në nxjerrjen e aktgjyimit [Ac. nr. 333/16,] të Gjykatës së Apelit të 10 shkurtit 2020. Siç është paraqitur edhe në pjesën e fakteve, parashtruesja në kërkesat e saj të paraqitura në Gjykatën e Apelit, krahas kërkesës për informata, ka paraqitur edhe një kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të rastit të saj nga kjo gjykatë.
89. Më saktësisht, gjatë periudhës prej 31 dhjetorit 2015 deri më 10 shkurt 2020, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur në Gjykatën e Apelit 9 (nëntë) kërkesa për përshpejtim dhe informata në lidhje me gjendjen aktuale të rastit të saj.
90. Lidhur me veprimet procedurale të parashtrueses së kërkesës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së ku ajo kishte sqaruar se parashtruesit të kërkesës i kërkohet të tregojë kujdes në ndërmarrjen e hapave procedural dhe për t'u përmbajtur nga përdorimi i taktikave të vonimit të shqyrtimit të rastit të tij (shih rastin e GJEDNJ-së: *Union Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës*, nr. [11681/85](#), Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35).
91. Në vijim dhe bazuar në veprimet e lartcekura të parashtrueses së kërkesës, Gjykata, nga data e paraqitjes së ankesës në Gjykatën e Apelit, përkatësisht nga data 31 dhjetor 2015 deri

në nxjerrjen e vendimit lidhur me padinë, përkatësisht aktgjykimin [Ac. nr. 333/16,] e Gjykatës së Apelit të 11 shkurtit 2020 konsideron se veprime të tilla procedurale mund të kenë ndikuar në vonesën e Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar meritat e rastit të saj..

(c) *Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore*

92. Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, [nr. 35382/97](#), Aktgjykim i Dhomës së Madhe i 6 prillit 2000, paragrafi 24; *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, [nr. 64480/09 64482/09 12874/10 56935/10 3129/12](#), Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91; *Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë*, nr. [33192/07 33194/07](#), Aktgjykim i 25 qershorit 2013; dhe *Abdoellakundër Holandës*, [nr. 12728/87](#), Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24).
93. Në këtë kontekst dhe në rrethanat e rastit konkret, Gjykata sjell në vëmendje faktin që GJEDNJ ka theksuar se nuk mund të merret parasysh arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura si arsyetim për procedura të tejzgjatura (shih rastet e GJEDNJ-së *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafët 70-71 dhe 94-96; *Krastanov kundër Bullgarisë*, [nr. 50222/99](#), Aktgjykim i 30 shtatorit 2004, paragrafi 74; *Vocaturro kundër Italisë*, nr. [11891/85](#), Aktgjykim i 1 prillit 1989, paragrafi 17; dhe *Cappello kundër Italisë*, [nr. 12783/87](#), Aktgjykim i 24 janarit 1992, paragrafi 17).
94. Megjithatë, në rastin e GJEDNJ-së, *Buchholz kundër Gjermanisë*, në lidhje me pretendimin e Qeverisë gjermane se si rezultat i recesionit ekonomik ka pasur rritje të konsiderueshme të vëllimit të proceseve gjyqësore në fushën e punësimit, duke rezultuar në mbingarkesë me lëndë të pazgjidhura përpara gjykatave, duke përfshirë gjykatat e Hamburgut, GJEDNJ ka sqaruar se: “[...] Konventa vendos detyrimin për Shtetet Kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që t’u lejojnë gjykatave të përmbushin kërkesat e nenit 6 paragrafit 1 [të KEDNJ-së] duke përfshirë atë të gjykimit brenda një “afati të arsyeshëm kohor”. Megjithatë, mbingarkesa e përkohshme me lëndë të pazgjidhura nuk i atribuon përgjegjësinë Shteteve Kontraktuese me kusht që ato të kenë ndërmarrë veprime të arsyeshme e të menjëhershme korrigjuese për t’u marrë me një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Buchholz kundër Gjermanisë*, [nr. 7759/77](#), Aktgjykim i 6 majit 1981, paragrafi 51).
95. Në linjë me qëllimin e qëndrimit të lartpërmendur të GJEDNJ-së, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore ka theksuar se gjykatat e rregullta kanë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t’i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që vonesat e tejzgjatura të mos shkaktojnë huti dhe pasiguri tek palët. Kësisoj, gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh këto detyrime dhe nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i publikut ndaj tërë rendit juridik do të minohej (shih në lidhje me këtë arsyetimin e Gjykatës në rastin [KI104/20](#), parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 62 dhe [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 11 gushtit 2022, paragrafi 98).
96. GJEDNJ po ashtu ka theksuar që përderisa nuk është funksioni i Gjykatës të analizojë mënyrën në të cilën gjykatat e rregullta kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin, megjithatë konsideron se aktgjykimet që anulojnë të gjeturat e mëparshme dhe që rikthejnë çështjen

në rivendosje, janë zakonisht për shkak të gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulëta dhe se përsëritja e gjykimeve të tilla mund të tregojë mangësi në sistemin e drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 147).

97. Gjykata vëren se në rastin parashtrueses së kërkesës, Gjykata e Apelit ndërmori disa veprime procedurale në lidhje me këtë proces, duke përfshirë njoftimin e të paditurës (Komuna e Shtimes) për paraqitjen e një përgjigjeje ndaj ankesës së parashtrueses së kërkesës, duke shqyrtuar secilën prej parashtrësive të saj deri në shqyrtimin e mbajtur më 11 shkurt 2020, në të cilën vendosi lidhur me ankesën, duke aprovuar të njëjtën si të bazuar. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se lidhur me ankesën e Komunës së Shtimes, Gjykata e Apelit ka vendosur në një periudhë më të gjatë se 4 vjet..
98. Në këtë drejtim, Gjykata megjithatë konsideron se gjatë shqyrtimit të rastit të parashtrueses së kërkesës nga Gjykata e Apelit, e njëjta, bazuar në parashtrësë, është dashur të ndërmerret veprime konkrete për të shqyrtuar dhe vlerësuar, nëse kërkesëpadia apo parashtrësia e parashtrueses së kërkesës në këtë gjykatë kanë paraqitur një rast që duhet të zgjidhet urgjentisht.

(d) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest

99. Lidhur me kriterin e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil, rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet e parashtruesve që vuajnë nga “*sëmundje të pashërueshme*” dhe kanë “*pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*”, si dhe rastet rreth të drejtës për arsim (shih rastet e GJEDNJ-së *Bock kundër Gjermanisë*, [nr. 11118/84](#), Aktgjykim i 21 shkurtit 1989, paragrafi 49; *Laino kundër Italisë*, [nr. 33158/96](#), Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 18; *Mikulic kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 44; *Hokkanenkundër Finlandës*, [nr. 19823/92](#), Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72; *Niederböster kundër Gjermanisë*, [nr. 39547/98](#), Aktgjykim i 27 majit 2003, paragrafi 39; *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45; *Vocaturò kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 17; *X kundër Francës*, nr. 18020/91, Aktgjykim i 31 marsit 1992, paragrafi 47; *A. dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 22 janarit 1996, paragrafët 78-81; *Oršudhe të tjerët kundër Kroacisë*, [nr. 15766/03](#), Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 109; dhe *Sailing Club of Chalkidiki “I Kelyfos” kundër Greqisë*, nr. [6978/18 8547/18](#), Aktgjykim i 21 nëntorit 2019, paragrafi 60, ku GJEDNJ-ja, mes tjerash, kishte theksuar se mungesa e pajustificuar e një vendimi brenda një periudhe posaçërisht të gjatë nga një gjykatë që e shqyrton çështjen mund të konsiderohet mohim i drejtësisë).
100. Gjykata rikujton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, përmes të cilit është aprovuar ankesa e komunës së Shtimes, aktgjykimi i shkallës së parë ishte modifikuar në atë mënyrë që padia e parashtrueses së kërkesës ishte refuzuar. Siç u theksua edhe më lart, është në diskrecionin e Gjykatës së Apelit të shqyrtojë nëse kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës është e një rëndësie të madhe, që kërkon urgjencë të veçantë nga kjo gjykatë..

## Përfundim

101. Në këtë rast konkret, Gjykata vlerësoi se lidhur me pretendimet për shkelje të parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme, përkatësisht me procedurat të cilat janë kryer në lidhje me kërkesën e parashtrueses për përsëritjen e procedurës bie në kategorinë (ii) e pretendimeve me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe si të tilla duhet të deklarohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
102. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës për interpretimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, Gjykata konkludoi se këto pretendime të parashtrueses së kërkesës i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe si të tilla duhet të deklarohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores. të punës..
103. Në lidhje me pretendimin e të parashtrueses së kërkesës përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e procedurës në Gjykatën e Apelit, në lidhje me shqyrtimin e rastit [Ac. nr. 333/16] të parashtrueses së kërkesës, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme. Për rrjedhojë, në kushtet e sipërpërmendura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vërtetuara edhe përmes praktikës gjyqësore të vetë Gjykatës në lidhje me të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me paragrafin 2, të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtrueses së kërkesës lidhet me zvarritjen e procedurës dhe dështimin e Gjykatës së Apelit që rasti [Ac. nr. 333/16] të zgjidhet brenda një kohe të arsyeshme është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese për shkak të “*mungesës së dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe duhet të deklarohet i papranueshëm në pajtim me paragrafin 2, të rregullit 39 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 të Rregullores së punës, më 24. prill 2023, njëzëri votash:

## VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani